



Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durres  
Mobile: +355697037155  
E-mail: info@liqeni7.al  
Website: www.liqeni7.al

## V E N D I M

### I ASAMBLESE SË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË "LIQENI VII" SH.A.

Shoqëria "LIQENI VII" sh.a., është një person juridik shqiptar, i regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 21244, dt.29.04.1999.

Sot më datën **01.03.2022**, në selinë e Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a., në Lagjia 14, Rruga "Dituria", Shkozet (Ish UMB) Durrës, u mbledh Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerëve të Shoqërisë, në të cilën ishin të pranishëm:

**Z. Ramazan Kalia**, që zoteron **99.96 %** të aksioneve, me të drejte vote ne perputhje me perqindjen e zoterimit të aksioneve të shoqërisë,

**Znj. Resilda Kalia**, me cilesine e **Administratorit të Shoqërisë**, pa të drejte vote,

**Z. Musa Kalia**, me cilesine e **Administratorit të Shoqërisë**, pa të drejte vote.

Per thirrjen e kesaj mbledhje asambleje eshte bere njoftimi i aksionereve nepermjet mesazhit elektronik nga administratori i shoqërisë dhe si date ne njoftim ishte data 04.02.2022.

Asambleja e zakonshme e Aksionarëve të Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a. e mbledhur sot më datën **01.03.2022**, në selinë e shoqërisë "LIQENI VII" sh.a., në Lagjia 14, Rruga "Dituria", Shkozet (Ish UMB) Durrës, pasi mori në shqyrtim rendin e ditës të caktuar nga Administratori Znj. Resilda Kalia si meposhte:

- 1. Celja e deges se huaj te Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a ne Mbreterine e Bashkuar.**
- 2. Te ndryshme.**

diskutoi si vijon:

Lidhur me piken e pare te rendit te dites, Z. Ramazan Kalia u shpreh se mbi baze te nje analize tregu per Mbreterine e Bashkuar te kryer nga departamenti i finances se Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a me fokus fushen e ndertimit, ekspertet e kompanise sebashku me z. Ramazan Kalia kane arritur ne perfundimin se eshte me shume interes financiar celja e nje dege te huaj te Shoqërisë "LIQENI VII" sh.a ne Mbreterine e Bashkuar. Kjo dege do te kete ekskluzivisht fokus zhvillimin e aktivitetit ne fushen ku Shoqëria meme "LIQENI VII" operon. Kjo dege hapet me qellim shfrytezimin e mundesive te reja te biznesit ne fushen e ndertimit qe te jep Mbreteria e Bashkuar, rritjen e kapitalit si dhe rritjen e te ardhurave te Shoqërisë meme nepermjet kesaj dege.

Z. Ramazan Kalia ne konsultim gjithashtu me ekspertet financiar te Kompanise vendosi se si Administrator i kesaj dege te juaj do te jete nje nga Administratoret aktuale te Shoqërisë meme Znj. Resilda Kalia.

Asambleja e aksionereve theksoi se Znj. Kalia pervecse ka nje ekperience te gjate ne administrimin e Shoqërisë meme ka gjithashtu perparesi si ne komunikim ashtu edhe ne perpunim informacioni e dokumentacioni financiar dhe ligjor ne gjuhen angleze pasi ka mbrojtur suksesshem edhe nje Master Shkencor ne Ekonomiks (Finance) ne Universitetin e Edinburgut ne Skoci.

Z. Ramazan Kalia shpjegoi gjithashtu se ne menyre qe kjo dege te vendoset ne funksion, administratori i Shoqërisë do te kaloje perpara proceduren e aplikimit per vizen e njohur si "Representative of an Overseas



**Address: Lagjia 14, Rruga "Dituria", Ish UMB, Shkozet, Durres**  
**Mobile: +355697037155**  
**E-mail: info@liqeni7.al**  
**Website: www.liqeni7.al**

Business Visa" ose ne Shqip "Viza per Perfaqesuesin e nje Biznesi te Huaj" procedure e cila do te ndiqet nga studio ligjore "Carter Thomas". Per rrjedhoje edhe lirimi nga detyra i Znj. Kalia do te vije menjehere sapo (nese) pergjigja e aplikimit te jete pozitive. Menjehere pas lirimimit nga detyra te Znj. Kalia, detyrat e saj ne Shoqerine meme do te merren teresisht nga Z. Musa Kalia, Administratori tjetër i Shoqerise.

Z. Ramazan Kalia u shpreh gjithashtu per pagen qe Znj. Kalia do te kete gjate punes se saj ne degen e huaj te Shoqerise "LIQENI VII" sh.a ne Mbreterine e Bashkuar e cila do te jete 4,000 pound ose 580,000 konvertuar ne Leke pa perfshire ketu te gjitha shpenzimet lidhur me seline e deges se huaj te Shoqerise "LIQENI VII" sh.a, shpenzimet administrative, kancelarike, shpenzimet qe lidhen me koston e jeteses se administratorit te Shoqerise si dhe bashkeshortit te saj (shtepi, automjet, telefon etj.) te cilat do te perballohen teresisht nga Shoqeria "LIQENI VII" sh.a.

Lidhur me piken e fundit te rendit te dites te ndryshme, Aksioneri prezent u shprehen se nuk ka ceshtje te tjera per te diskutuar e miratuar.

Per sa me lart, ne mbështetje të Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Asambleja e shoqërisë "LIQENI VII" sh.a,

#### **V E N D O S I :**

1. Celjen e deges se huaj te Shoqerise "LIQENI VII" sh.a ne Mbreterine e Bashkuar.
2. Ndjekjen e procedures ligjore per "Representative of an Overseas Business Visa" ose ne Shqip "Viza per Perfaqesuesin e nje Biznesi te Huaj" me studion ligjore "Carter Thomas".
3. Ndermarrjen e hapave te metejsjme per lirimin nga detyra te Znj. Resilda Kalia si administratore e Shoqerise meme "LIQENI VII" sh.a dhe caktimin e saj si administratore e deges se huaj te Shoqerise "LIQENI VII" sh.a ne Mbreterine e Bashkuar ne rast se aplikimi per vize i Znj. Kalia rezulton i sukseshem.
4. Dokumentacioni i pergatitur per miratimin e pikave te rendit te dites te mbledhjes se Asamblese se Aksionereve te dates 01.03.2022 te depozitohet ne QKB sipas kerkesave ligjore dhe te Statutit te Shoqerise.

Ky vendim u miratua unanimisht nga aksionarët pjesemarres dhe konkretisht nga Aksioneri Kryesor Z.Ramazan Kalia qe zoteron 99.96 % te aksioneve te Shoqerise "LIQENI VII" sh.a.

**Per "LIQENI VII" sh. a**

**Z. Ramazan KALIA**

**Aksioner Kryesor**

*Ramazan Kalia*

*[Signature]*